



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primiteno/Prodato Received/Delivered	21-04-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	2316/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A . Nr. 249/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr. 249/2021, të datës 17.03.2022, së ankuesit me adresë banimi Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.04.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa me numër A.Nr.249/2021 e datës 17.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi, vendimi me numër 13-112/12-0018975/22 i datës 14.03.2022, i Komisionit për Vlerësimin dhe Lëvizjes Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës, me datë 21.01.2022, ka shpallur konkursin për pozitën “Drejtor i Qendrës për Punë Sociale”, lëvizje brenda kategorisë, në të cilin konkurs ka aplikuar ankuesi ndërsa me datë 07.03.2022, Komuna e Podujevës ka bërë njoftimin për anulimin e konkursit për arsye se kandidati nuk i ka arritur gjashtëdhjetë (60) pikë.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me njoftimin e datës 07.03.2022, me datë 08.03.2022, me ankesë i është drejtuar Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë.

Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë, me datë 14.03.2022, me numër protokoll 13-112/12-0018975/22, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi [redacted] i pakënaqur me vendimin e datës 14.03.2022, me numër protokoll 13-112/12-0018975/22, me datë 17.03.2022, me numër protokoll 1424/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", lëvizje brenda kategorisë, të zhvilluar nga Komuna e Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 25.03.2022 me numër protokoll 1584/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Podujevës, ndërsa me datën 01.04.2022 me numër protokoll 1778/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A Nr. 249/2022, e datës 17.03.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 1424/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 14.03.2022, me numër protokoll 13-112/12-0018975/22, e Komisionit për praninë; Konkursi i datës 21.01.2022; Ankesa e datës 08.03.2022, drejtuar Komisionit të pranimit; Njoftimi me numër protokoll 13-34/2022 i datës 23.02.2022; Njoftimi i datës 15.02.2022; Vlerësimi individual i datës 03.03.2022; Diplomë me numër 552, i datës 10.10.2003; Certifikatë e datës 07.01.2005; Vërtetim i datës 19.02.2021; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022; Vërtetim i datës 03.02.2022; Renditja përfundimtare e kandidateve; Vendimi i datës 21.02.2022, për themelimin e komisionit për vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë; Njoftimi i datës 02.03.2022; Njoftimi i datës 15.03.2022; Njoftimi i datës 07.03.2022; Përgjigje në ankesë e datës 30.03.2022, me numër protokoll 1778/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit [redacted] të parashtruara në ankesë lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", lëvizje brenda kategorisë, të zhvilluara nga Komuna e Podujevës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, të gjitha provat dhe faktet relevante lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Përmbledhje e fakteve dhe provave relevante lidhur me publikimin e konkursit. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton së në konkursin e shpallur më datë 21.01.2022, për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", lëvizje brenda kategorisë, kriteret e konkursit kanë qenë:

- **Diplome e studimeve Universitare; me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to, në fushë të punës sociale, psikologjisë, Sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë, ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare**
Minimumi (5) vite përvoja pune profesionale

Bazuar në shkresat e lendes del së ankuesi [redacted] pasi që i është nënshtruar konkurrimit për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", dhe është përzgjedhur në listën e ngustë si i vetmi kandidatit për pozitën e lartë cekur si dhe ka marr pjesë në intervistën me gojë, nga Komisioni për vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë ankuesi [redacted] është vlerësuar me gjithsejtë 40.4, andaj kolegji konstaton së pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankuesi nuk i ka arritur piket e mjaftueshëm ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së Komisioni për vlerësimin brenda kategorisë, ka vepruar në pajtim me nenin 38, paragrafi 1,6, nën paragrafi 6.1.6.2 Ligjit NR. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se; **Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.**

Ndërlidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit nga Komuna e Podujevës, kolegji ka konstatuar së Komuna e Podujevës në rastrin e përfundimit të procedurës së rekrutimit i rekomanduar nga Komisioni ka vepruar në pajtime me dispozitat ligjore neni 48, paragrafi 1 neni 49, paragrafi 1,2,3 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së 1. Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjestohen me pesë. 1. KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2. Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues, prandaj kolegji konstaton se në bazë të renditjes përfundimtare të bërë nga komisioni i vlerësimit brenda kategorisë ankuesi [redacted] për pozitën „Drejtor i Qendrës për Punë Sociale“, nga komisioni është vlerësuar me

gjithsejtë katër dhjetë pikë katër pikë (40.4), me çka nënkupton së ankuesi nuk ka mundur ti realizojë pikët e kërkuara për t'u emëruar në pozitën e lartë cekur.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, së Menaxheri i Personelit i Komunës së Podujevës, në rastin e njoftimit të datës 07.03.2022, me numër protokollit 13-111/01-0017065/22, lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit lëvizje brenda kategorisë, për pozitën "Drejtor i Qendrës për Punë Sociale", ka vepruar në pajtim me neni 49, paragrafi 4, të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së **4. Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatit e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes brenda kategorisë i Komunës së Podujevës, me nxjerrjen e Vendimit të datës 14.03.2022, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se kandidati nuk ka arritur pikë fituese dhe së procedura e rekrutimit ka rezultuar pa kandidat fitues, ka vepruar në pajtim, në pajtim me nenin 50, paragrafi 2, të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së **2. Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj, sepse ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit, për pozitën „Drejtor i Qendrës për Punë Sociale“.**

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit [REDAKTUAR] i cili pretendon se në konkursin e publikuar në muajin mars të vitit 2020, konkursin e datës 31.05.2021, për pozitën Drejtor i Qendrës për punë Sociale", i cili është mbajtur në pallatin e Drejtësisë në Prishtinë, i cili pretendon se ka kaluar testim me shkrim, pasi që ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar se pretendimet ankimore nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankesën në këshill e ka parashtruar jashtë afatit ligjore, për parashtrimin e ankesave, dhe këtë pretendim ankimore kolegji nuk e ka shqyrtuar se veprimi juridik lidhur me parashtrimin e ankesës, nga ankuesi është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.249/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

